



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 65

Prishtinë, më 18 maj 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L

**I M B L E D H J E S S Ë K O M I S I O N I T T Ë S H Ë N D E T Ë S I S Ë, T Ë P U N Ë S
D H E T Ë M I R Ë Q E N I E S S O C I A L E**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Teuta Hadri, Qamile Morina dhe Vezira Emrush.

Mungoi: Flora Brovina.

Të pranishëm: Xhezair Murati dhe Enis Kervan – deputetë të Kuvendit, Sevi Anac – Ambasada Turke, Nora Sahatçiu – UNDP, Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit dhe Liridon Selmani – KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 11. 05. 2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe për mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve;
5. Shqyrtimi i Propozimplanit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 11. 05. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës;

Sadik Idriz – Tha se Komisioni e ka në rendin e ditës raportin përfundimtar për këtë Projektligj, sepse ai dhe amendamentet e propozuara janë shqyrtuar nga komisionet kryesore. Ne e kemi rekomandimin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, i cili e ka propozuar një amendament për ndryshimin e titullit të Projektligjit. E kemi edhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që e përkrah amendamentin e propozuar të Komisionit të Komuniteteve. Amendamenti i propozuar i Komisionit të Komuniteteve e ka këtë përmbajtje: *“Në titullin dhe në tërë tekstin e Projektligjit të shtohet teksti si vijon: Gjysmëhënën e Kuqe të Republikës së Kosovës”*. Ky propozimamendament është i njëjtë me propozimin e deputetit Riza Smaka. Ne tani po e miratojmë ligjin për Kryqin e Kuq. Komisioni për Komunitete mendon se ligji duhet të quhet Ligji për Kryqin e Kuq dhe për Gjysmëhënën e Kuqe, ndërsa sa i përket regjistrimit në organizatën e Kryqit të Kuq, është çështje tjetër. Kuvendi do ta thotë fjalën e vet, a do ta pranojë ose jo amendamentin e propozuar nga Komisioni për Komunitete. Hap diskutimin.

Vezira Emrush – Jam e njoftuar për propozimin e Komisionit për Komunitete. Nëse është e mundur, e përkrah propozimin që të jenë të dy emërtimet e Projektligjit. Ky është një ligj për një shoqatë humanitare, e cila duhet t’i përfaqësojë të gjitha etnitetet që jetojnë në Kosovë. Unë e përkrah këtë amendament dhe do ta votoj.

Gjylnaze Sylja – Nuk jam kundër që ligji të quhet: Ligji për Kryqin e Kuq dhe Gjysmëhënën e Kuqe. Kisha propozuar t’i shtohet edhe emërtimi Kristali i Kuq, por duhet të dihet qëllimi përse është bërë ky ligj. Ky ligj është bërë që Kryqi i Kuq i Kosovës të anëtarësohet në Federatën e Kryqit të Kuq, të Gjysmëhënës së Kuqe dhe të Kristalit të Kuq. Nuk lejohet që Kosova të aplikojë për anëtarësim në Federatë me dy emërtime, por vetëm me një. Meqenëse pas anëtarësimit në Federatë, Kosova do të jetë pjesë e Federatës së Kryqit të Kuq, e Gjysmëhënës së Kuqe dhe e Kristalit të Kuq, e përkrah propozimin që ligji të quhet vetëm Ligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Ne nuk kemi asgjë kundër, por duhet ta kemi parasysh kriterin e anëtarësimit në lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të Kuq, të Gjysmëhënës së Kuqe dhe të Kristalit të Kuq.

Teuta Hadri – Nuk kemi nevojë ta shtojmë emërtimin Gjysmëhënën e Kuqe, sepse edhe më parë e kemi pasur Kryqin e Kuq. Ne po pretendojmë të jemi pjesë e Evropës dhe nuk kemi nevojë ta ndërrojmë emrin që e kemi pasur edhe më herët.

Nurishahe Hulaj – Unë e mbaj qëndrimin që e kam thanë edhe në mbledhjen e kaluar që ligji të quhet Ligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës.

Qamile Morina – Pajtohem se nuk kemi asgjë kundër emërimit me dy emra të ligjit. Nëse paraqet pengesë për anëtarësim në Federatën e Kryqit të Kuq, të Gjysmëhënës së Kuqe dhe të Kristalit të Kuq, ndryshon puna, sepse qëllimi i këtij ligji është anëtarësimi në Federatë. Mendoj se nuk duhet ta cenojmë qëllimin.

Gjylnaze Sylja – Nëse Komisioni pajtohet të shtohet në titullin e Projektligjit edhe emërtimi Gjysmëhënën e Kuqe, propozoj të shtohet edhe emërtimi Kristali i Kuq.

Sadik Idriz – Të gjithë kemi të drejt t’i shprehim mendimet. Do të diskutojmë dhe do të votojmë për amendamentin e propozuar nga Komisioni për Komunitete, që është përkrahur përkrahur nga Komisioni për Buxhet.

Gjylnaze Syla – Nëse fillojmë t'i votojmë propozimet, kërkoj të votohet edhe propozimi që e dhashë më herët për emrin e Projektligjit. Kërkoj të sigurohemi se a do të pranohemi në lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të Kuq, të Gjysmëhënës së Kuqe dhe të Kristalit të Kuq.

Sadik Idriz – Komisioni për Buxhet e ka përkrahur propozimin e Komisionit për Komunitete. Ne sot do të votojmë për amendamentin e propozuar. Regjistrimi në Federatën e Kryqit të Kuq, të Gjysmëhënës së Kuqe dhe të Kristalit të Kuq është një proces i ndarë nga ligji dhe miratimi i tij. Ne po e miratojmë një ligj, i cili e rregullon këtë materie, ndërsa procedura e regjistrimit do të jetë e veçantë.

Pas diskutimeve Komisioni votoi për amendamentin e propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, që ishte përkrahur nga Komisioni i Buxhetit:

Komisioni Funksional, me 2 vota për dhe me 4 kundër, nuk e përkrahu amendamentin e propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Gjithashtu Komisioni me shumicë votash u pajtua që të tri propozimet për ndryshimin e titullit të ligjit të shkojnë me një amendament.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe për mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve

Komisioni e shqyrtoi amendamentin e propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, që ishte përkrahur nga Komisioni për Buxhet, që në titullin dhe në tërë tekstin e Projektligjit, pas fjalëve: „emblemës së Kryqit të Kuq, të shtohet teksti si vijon „dhe emblemës së Gjysmëhënës së Kuqe”.

Pas diskutimeve Komisioni votoi për amendamentin e propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve që ishte përkrahur nga Komisioni i Buxhetit.

Komisioni Funksional, me shumicë votash, nuk e përkrahu amendamentin e propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

5. Shqyrtimi i Propozimplanit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian

Komisioni këtë pikë e la për diskutim në mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme

Sadik Idriz – Për këtë pikë ia japim fjalën Nora Sahatçiu, zyrtare e UNDP-së, të na e paraqesë propozimin lidhur me takimin e radhës për shqyrtimin e draftdokumentit për gjendjen në shëndetësi, të propozuar nga UNDP-ja.

Nora Sahatçiu – Siç jeni të informuar draftdokumenti i propozuar është plotësuar me komentet në takimin e fundit. Për mbledhjen e radhës propozoj të shqyrtohet edhe një herë, edhe me disa përfaqësues të shoqërisë civile, në mënyrë që ky dokument ta marrë formën përfundimtare. Gjatë takimit të radhës do të pajtoheni edhe për emërtimin e dokumentit, që do ta quani deklaratë e qëndrimeve të Komisionit ose me ndonjë emër tjetër. Gjithashtu do të

diskutojmë si do të procedohet. Do të procedohet në Kuvend ose do të miratohet vetëm si dokument i Komisionit.

Pas diskutimeve Komisioni u pajtua që takimi i propozuar nga UNDP-ja të mbahet të martën, më 25 maj 2010, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz